

Edicioni i parë

Brass

17-21 MAJ


International Albanian Brass Festival

SHOQATA ARTISTËT INTERPRETË





Photo by Boudewijn van den Breen



**BASHKIA
TIRANË**

A photograph of Ermal Sela, a young man with dark hair and a slight smile, wearing a white shirt. He is holding a traditional Albanian instrument, likely a gitarë e vogël (small guitar), in his hands. In the background, there is a blurred image of another person wearing a red and white patterned headscarf.

Ermal Sela '1985 Tirane'

"koleksionist"

Pasi mbaroi studimet në liceun artistik 'Jordan Misja' me pedagog L. Gjergji, vazhdoi studimet për Trombë në 'Universitetin e Arteve'nën drejtimin e pedagogut Sokol Saraçi. Ka luajtur në instrumentin e kitarës bass në grupe të ndryshme pop-rock dhe ansamble popullore si ai i "Ansamblit Tirana" duke përfituar njohje të shumë rrymave muzikore. Gjatë Festivalit Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës "Argjiro Fest. 2016", ka qenë pjesë e Komisionit Përzgjedhës për grupet pjesmarrëse. Qysh prej vitit 2000 është angazhuar në mbledhjen dhe koleksionimin e instrumentave të rrallë tradicional shqiptar. Sot koleksioni i tij përbën mbi 100 instrumenta të licensuar e të temperuar, veshje tradicionale dhe shumë artikuj që janë mbi 100 vjeçar.



National
OPERA &
BALET


TKOB



PRISHTINA BRASS



PËRBËHET NGA PJESETARË TË FILHARMONISËS KOSOVËS, OKRESTRËS FRYMORE TË FORCËS SË SIGURISË DHE DY NGA PJESTARËT JANË PEDAGOGË NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS. KY FORMACION KA REALIZUAR NJË NUMËR TË MADH KONCERTESH NË SALLA DHE NË AMBJENTE TË HAPURA NË KOSOVË E MAQEDONI. STILI MUZIKOR I TYRE ËSHTË NJË GËRSHETIM I PERJUDHAVE TË NDRYSHME MUZIKORE DUKE MOS PËR-JASHTUAR EDHE VEPRAT DHE KËNGËT E NDRYSHME TË DITËVE TË SOTME. JANË MJAFT AKTIV NË FESTIVALE TË NDRYSHME SI: "REMUSICA", "NETËT E PRISHTINËS", "FESTIVALI HAPU" ETJ.



Albanian National Brass

I formuar këtë vit, Albania National Brass, ështe një formacion i ri i muzikës së dhomës dhe jo vetëm. Anëtarët e këtij ansamblit janë artistë të rinj, profesionistë të aftë, por dhe shumë miq me njëri-tjetrin. Pa llogaritur kostot, ata kanë arritur sot qëllimin e tyre për të ngritur një ansambël mjaft të rrallë jo vetëm në vendin tonë por në të gjithë rajonin. Pjesmarrja e tyre në këtë festival do të jetë një ogur i mirë për të gjithë ne dhe një premierë e këtij formacioni.



Raiffeisen
INVEST




P A U L G O O D C H I L D 'Australi'

Ka qenë pjestar i Orkestrës Simfonike të Sydney-t që 18 vjec. Më 2001 në Konservatorin e Shenyang, Kinë, jep master-class dhe koncerete të shumta si solist. Më 2005 me ork. simfonike të Sydney-t jep premierën koncertit për Trombë "Doppler's Web" të kompozitorit A. Holley duke e përsëritur atë më 2006 me ork. simfonike të Queensland. Në fillim të vitit 2011 u paraqit si solist me Sting dhe ork. simfonike të Australisë. Në vitin 2010 interpreton pjesën "Ornithologia" të A. Holley në hapjen e konferencës ndërkombëtare të trombisteve në Sidney. Kompozitorët më të mirë australianë si Carl Vine, Ross Edwards, Barry Mc Kimm dhe Matthew Hindson kanë kompozuar një numër veprash për të

Paul ka qenë Pedagog i klasës sëtrombës në Konservatorin e Sidney-it nga 1996-2006. Ai është Pedagog i ftuar në Konservatorët e Newcastle dhe Wollongong si dhe në kampet muzikore të "Pan Pacific" dhe "Youth Music Australia". Paul është Drejtori "Waverley Bondi Beach Band" dhe "Sydney Brass". Ai ka një numër të madh regjistri-mesh me shtepitë diskografike më në zë në bote.



A close-up portrait of Alan Holley, an elderly man with long, wavy grey hair and a prominent white mustache. He is wearing a red button-down shirt. The background is dark and out of focus.

ALAN HOLLEY

(1954 Australi)

.Eshtë një nga kompozitorët më të famshëm australian. Veprat e tij janë perfshirë në kurikulën e Bordit Australian të Testimeve. Kompania gjigande muzikore EMI ka publikuar shumë kompozime të tij që arrijnë në më shumë se dy albume. Alan Holley është një artist nderi i Kompanisë Muzikore 'KOOKABURRA MUSIC'. Disa nga kompozimet e tij si koncerti për trombë 'Doppler's Web' (2005), si dhe vepra 'A line of Stars' (2007), të dyja të performuara nga Orkestra Simfonike e Sýdney-t, i janë dedikuar trombistit Paul Goodchild. Gjithashtu këto punime janë prezantuar edhe në CD nga 'Hammerings Records'.



KRISTINA BJELOPAVLOVIĆ CESAR ‘KROACI’

Pasi përfundon studimet në Universitetin e Zagreb-it, mori pjesë si soliste me Orkestrën Simfonike të Dubrovnikut, Solistët e Filarmonisë së Zagrebit, dhe me Ork.Teatrit të Operas, Kroaci. Ka regjistuar koncerte si atë të kompozitorit Silvio Bombardelli dhe Boris Papandopulo me Ork. Simfonike të Radio -Televizionit Kroat. Ka dhënë shumë koncerte në: Tokio, Kawasaki, Osaka, Kobe, Kyoto, Akita, të Japonisë. Ka qenë aktive në; Festivalin e Natës Verore. Zagreb, Festivalin “Artistët e Zagrebit për Publikun e Zagrebit”, ‘Festivalet e Muzikës Kroate’ në Berlin, Vjenë etj. Është fituese e 6 çmimeve të para në shkollën e mesme dhe konkurseve studentore universitare në Kroaci, si dhe fituese e çmimit të Rektorit për vitin 2002 - 2003.

Milan Roksandic '1973 Serbi'

Ka studjuar në Universitetin e Beogradit
dhe në atë të "Giuseppe Verdi"

Ka fituar cmimin e parë dhe të dytë në
konkurset ndërkombëtare të Paviaj dhe
Verbanias (Itali)

Nga viti 2003-2009 luan kornin e parë
në Ork. Simfonike të Radio-Televizionit,
Serbi. Nga 2009 - 2013 luan kornin e
parë në Filarmoninë e Beogradit dhe nga
viti 2013 e në vahdim luan kornin e
parë në Orkestrën e Operas së Beogra-
dit. Ka bashkëpunuar me Orkestrën

"Jozef Haydn" Bolzano, Orkestrën Sim-
fonike "Giuseppe Verdi" Milano,
Orkestrën Simfonike të San Remos, Fil-
harmoninë e Seulit në Korenë e Jugut,
Filharmoninë e Maqedonisë dhe Filhar-
moninë e Lubjanës. Nga 2009 rregullisht
regjistron muzikë filmash për kom-
paninë "Film Recording". Shkup. Ështe
pjestar i kuintetit 'Brass Sense'



Erga Halilaj '1988 Tiranë'

Vazhdoi studimet në Liceun Artistik "Jordan Misja" dhe më pas në Akademinë e Arteve në klasën e prof. Nora Çashkut, nga ku përfundon studimet me nota maksimale. Numëron një numër të madh koncertesh si soliste në ansamble të ndryshme të muzikës së dhomës, me Filarmoninë e Kosovës dhe gati cdo vit me Orkestrën Simfonike të RTSH-së. Prej 6 vitesh është Koncert Maestër në Orkestrën Simfonike të RTSH-së dhe Pedagoge e ftuar pranë Universitetit të Arteve në Tiranë.





Vila
60





JAlbaniaZZ Society

Big Band

BigBand me te njejtin emer eshte eshte pjese e disa projekteve te muzikes JAZZ ne Tirane e me gjere. E krijuar pak kohe me pare nga disa JAZZ muzikant me pervoje dhe muzikant te rinj teper te talentuar, ka bere disa koncerete te sukseshme. BigBand ka nje repertor te pasur te ketij zhanri (swing funky blues latin etj) dhe muzike shqiptare te riaranxhuar.

Ilir Kodhima

Drejtor Artistik

Në vitin 2000 konkuron pranë Liceut Artistik "Jordan Misja" dhe fillon mësimet para për korno në drejtimin e pedagogut Avni Dajko. Përfundon studimet e larta më 2008 për korno pranë UA nën udhëheqjen pedagogut Andrea Canaj. Merr pjesë më pas në shumë kurse vorore universtare me pedagogë të njohur si: Mike Svoboda - Austri, Markus Burghaier - Gjermani, Uwe Diekersen - Gjermani, Vangelis Scuras - Greqi, Guido Corti - Itali etj. Luan si solist dhe është pjestar në disa ansamble të muzikës së dhomës. Është fitues i cmimit Absolut në konkursin ARS Kosova. Nga viti 2008-2009 luan pranë Orkestrës Simfonike të RTSH-së dhe nga viti 2009 pranë TKOB. Aktualisht luan kornon e parë pranë TKOB dhe pedagog i ftuar pranë UA.








ANDREA CANAJ
PRESIDENT I FETIVALIT

Përfundon studimet pranë Universitetit të Arteve më 1986 nën drejtimin e pedagogëve Dhimitër Gjergji dhe Kristofor Qorri. Më vonë specializoet me pedagogun Adrie Van der Ween, Hollandë. Gjatë karierës së tij për më se 25 vjet luan kornin e parë në Orkestrën Simfonike të Teatrit të Operas dhe në Orkestrën Simfonike të R.T.SH.-së. Eshtë anëtar i Kuntetit Frymoris -ZADEJA - themeluar më 1986. Ka drejtuar klasën e Kornos në Konservatorit e Epirit në Janinë (1999-2004), Që nga viti 1993 është profesor i klasës së kornos pranë U.A dhe pedagog prane Fakultetit të Arteve në Universitetin 'Hasan Prishtina'



President
Andrea Canaj
Drejtor Artistik
Ilir Kodhima
Design
Kedi Mëniku